



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 13, datë 12.04.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "SHITESË NË SIPËRFAQE
DHE RISHIKIMI I KUSHTEVE TË LEJES EKZISTUESE TË RESORTIT TURISTIK
"GREEN COAST", PALASË, BASHKIA HIMARË


Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të shoqërisë "Green Coast" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Për miratimin e lejes së ndërtimit për objektin: "Shtesë në sipërfaqe dhe rishikimi i kushteve të lejes ekzistuese të resortit turistik "Green Coast", Palasë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Green Coast" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 8, datë 07.03.2014 "Për miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për Resortin Turistik "Green Coast", Palasë, Bashkia Himarë, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit, sipas fazave të përcaktuara në hartën bashkëlidhur këtij vendimi, i jepen subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BLENDI KLOSI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT



SEKRETAR/ ANËTAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

